



Numri i Biletës (Request/Proforma Receipt/Delivery)	23 - CG 7	viti god year	
Emri i Rrjesit Çështje/Jedësia Gr./Unit	Nr. Prot. Bz. Prot. Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	3133/2017		111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 33 /2017
Datë: 23.06.2017

Në mbështetje të nenit 10 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 Për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.10 dhe 1.14, nenit 10 të Rregullores Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 13 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 si dhe nenit 14 të Rregullores Nr. 01/2015 për Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues, pasi shqyrtoi raportin me rekomandimin e Kolegjit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Menaxher i Personelit” në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, Këshilli në mbledhjen e dymbëdhjetë (XII) të mbajtur më datë 23.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Menaxher i Personelit” në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, me të cilin **anulohet** procedura e rekrutimit sepse është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, për zbatimin këtij vendimi, brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti i Kolegjit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Menaxher i Personelit” në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Shkëmb MANAJ

Kryetar i Këshillit



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”;
- Menaxheri të Personelit të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” dhe
- Arkivit të Këshillit.



Numri i Këshillat	23. CG	7
SKIMSHICK	3133/2017	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për vëzhgim i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryesuese dhe Zyle Millaku-Gojnovci-bashkëpunëtore profesionale, bazuar në nenin 16 paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 03/L -192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues dhe Vendimin Nr. VK/70/2017 të datës 15.03.2017 për pjesëmarrje në procedurën e vëzhgimit për pozitën „Menaxher i Personelit” në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, me datë 22.06.2017, paraqet këtë:

R A P O R T

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.03.2017 është njoftuar nga Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”, për shpalljen e konkursit të jashtëm të datës 15.03.2017 për pozitën „Menaxher i Personelit”, duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 15.03.2017 nxjerr Vendim Nr. VK/70/2017 me numër protokolli 1195/2017 me të cilin bënë emërimin e Kolegjit lidhur me vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Menaxher i Personelit”, në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që e përcjell procesin e rekrutimit është vërtetuar se shpallja e konkursit është bërë mbi bazën e shkresës së aprovimit për autorizim të shpalljes publike të lëshuar nga DASHC-Ministria e Administratës Publike e datës 10.03.2017.

Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar se kushtet kryesore të parashtruara në konkursin e rishpallur për pozitën „Menaxher i Personelit”, në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, kanë qenë:

- *Diplomë Universitare;*
- *Minimum pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për vëzhgim, konform dispozitave të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe procedurat e Vëzhgimit Për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar të datës 15.03.2017. Këshilli më datë 17.03.2017 i është drejtuar me shkresë zyrtare Zyres së Personelit në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, lidhur zhvillimin e procedurës së rekrutimit, duke e njoftuar që pas mbylljes së konkursit dhe përfundimit të gjithë procedurës së rekrutimit të njoftohet Këshilli me të gjitha materialet e procedurës. Zyra e Personelit në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, më datë 29.03.2017, ka njoftuar Kolegji lidhur me zgjatjen e afatit të konkursit edhe për shtatë (7) ditë.

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” më datë 10.05.2017 ka përcjell në Këshill të gjithë dokumentacionet e procedurës së rekrutimit për pozitën “Menaxher i Personelit”. Kolegji për vëzhgim, ka shqyrtuar të gjitha dokumentacionet dhe ka konstatuar se Sekretari i Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”, më datë 12.04.2017 ka nxjerr Vendimin me Nr. Prot: 03/634 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil prej pesë (5) anëtarëve, me këtë përbërje:



1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 14/10/2010,

2. Vaxhid Sadriu, Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan-anëtar;
3. Azem Jashari- Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj-anëtar;
4. Mihajlo Perlineviç-Drejtor i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në MKK-anëtar;
5. Mursel Zymeri, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale-anëtar;

Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil është themeluar në pajtim me nenin 7 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se për pozitën "Menaxher i Personelit", kanë aplikuar njëzetetë (23) kandidatë si në vijim:

1. Bardhyl Sylja,
2. Kosovare Shabani;
3. Skender Hoda,
4. Florim Mustafa,
5. Burbuqe Agaj,
6. Besart Bekteshi,
7. Valarta Qerimi,
8. Drita Milazimi,
9. Antigona Keka,
10. Uran Salihu,
11. Afrim Isufi,
12. Arber Zeqiri,
13. Fatmir Maliqi,
14. Arta Shahiqi,
15. Florent Leka,
16. Vlora Morina,
17. Miranda Demolli,
18. Aysel Abdullah,
19. Lindita Fazliu,
20. Nuriye Saçipi,
21. Naim Maliqi,
22. Ermira Bajrami,
23. Vigan Berisha.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve dhe më datë 13.04.2017 ka përgatitur listën e shkurtër prej trembëdhjetë (13) kandidatëve si në vijim:

1. Bardhyl Sylja,
2. Kosovare Shabani,
3. Skender Hoda,
4. Florim Mustafa,
5. Besart Bekteshi,
6. Drita Milazimi,
7. Antigona Keka,
8. Arber Zeqiri,
9. Fatmir Maliqi,
10. Arta Shahiqi,
11. Lindita Fazliu,
12. Naim Maliqi,
13. Vigan Berisha.

KOJO
KOSOVA
JANUARI 2017



KOMISIONI
PËR SHËRBITIM CIVIL
PRISHTINË

Kryesuesja e Kolegjit për vëzhgim, më datë 12.06.2017 ka parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit të nxjerrjes së vendimit lidhur me raportin për vëzhgimin e kësaj procedure, kërkesë e cila me Vendimin me Nr. 22/2017 të datës 06.06.2017 të Kryetari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është miratuar.

Kolegji për vëzhgim, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës respektivisht Autorizimit të lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike të datës 10.03.2017, ka konstatuar se aprovimi për shpalljen lidhur me kualifikimin profesional është bërë si në vijim: *"Aprovohet kërkesa. P.S kriteri i kualifikimin të jetë nga drejtimet si: Juridik, Administratë Publike, Ekonomik ose ndonjë drejtim ngjashëm me qëllimin e vendit të punës dhe përshkrimin e detyrave të punës..."*, ndërsa Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", në konkursin e datës 15.03.2017 si kriter të kualifikimin e ka përcaktuar "Diplomë Universitare" që është në kundërshtim me dispozitat e 16 paragrafit 1 nënparagrafit 1.8 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se: *"Shpallja e rekrutimit përmban: kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvojën paraprake e punës"*, me këtë nënkuptohet se nuk mund të bëhet asnjë ndryshim nga ai që është aprovuar në autorizim pa miratimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike. Duke marrë parasysh këtë fakt, Kolegji për vëzhgim ka konstatuar se Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", kualifikimin profesional në konkursin e shpallur të datës 15.03.2017 për pozitën „Menaxher i Personelit“, e ka bërë në kundërshtim me Autorizimin për shpalljen për rekrutim të lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike të datës 10.03.2017.

Bazuar në nenin 16, paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 5 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues dhe dokumentacionin e shqyrtuar gjatë procesit të vëzhgimit, Kryesuesja e Kolegjit për vëzhgim, paraqet këtë:

Rekomandim

Kryesuesja e Kolegjit për vëzhgim, ka konstatuar se Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", në lidhje me procesin e rekrutimit për vendin e punës: *"Menaxher i Personelit"*, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kryesuesja e Kolegjit për vëzhgim, **i rekomandon** Këshillit që të **anulohet** përzgjedhja përfundimtare e kandidatit për pozitën *"Menaxher i Personelit"* në Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka".

Kryesuesja e Kolegjit për vëzhgim rekomandon Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka", që në rast të shpalljes së serishme të konkursit për pozitën *"Menaxher i Personelit"* të veproj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryesuese e Kolegjit

Zyle GOJNOVCI

Bashkëpunëtorë Profesionale

I dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Dosjes së lëndës.